

**P.nr. 839/12**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA** – në trupin gjykues të përberë nga gjyqtarja Shadije Gërguri- kryetare e trupit dhe anëtarëve të trupit gjykues-gjyqtarët Beqir Kalludra dhe Shashivar Hoti, me procesmbajtësin Arianit Mahmutaj në lëndën penale ndaj të akuzuariëve E. O. për shkak të veprës penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.1 lidhur me par.4 dhe 5 të KPK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së, të akuzuarit E. V., G. A., A. T., F. T. dhe F. E. për shkak të veprës penale: Moslajmërimi i veprës penale nga neni 304 par.2 të KPK-së sipas aktakuzës së ish Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë PP.nr.120-2/2010, të dt:13.08.2012, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë verbal e publik, në prezencë të prokurorit të shtetit Armend Hamiti, të akuzuarit E. O. dhe mbrojtëses së tij av.F. G. B., me dt: **29.11.2017** publikisht shpallë:

**A K T G J Y K I M**

Ndaj të akuzuarëve:

**E. O.**, nga i ati I., e ëma H., e vajzërisë I., i lindur me dt. *Data e lindjes...* në P., ku dhe tani jeton në lagjja D., rr. ...” nr. KK-Prishtinë, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i dy fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. Me nr. Personal: *numri personal...*

**E. V.**, nga i ati R., e ëmaLumnije, e vajzërisë J.,i lindur me dt: *data e lindjes...*, në P., nr rr. V., ku edhe jeton, Shqiptar Shtetas i R.Kosovës,

**G. A.** nga i ati S., e ëma Sh., e vajzërisë B., i lindur me dt: *data e lindjes...* në fshatin “G. e U., Komuna e L., ku edhe jeton, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i R.Kosovës,

**A. T.**, nga i ati M., e ëma F., e vajzërisë K., i lindur me dt: *data e lindjes...* në fshatin “G. e U.’, Komuna e L., ku edhe jeton, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i R.Kosovës.

**F. T.**, nga i ati M., e ëma F., e vajzërisë K., i lindur me dt: *data e lindjes...* në fshatin ‘G. e U. K-L., ku edhe jeton, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i R.Kosovës,

**F. E.**, nga i ati R., e ëma N., e vajzërisë A., I lindur me dt: *data e lindjes...*, në fshatin ‘G. e U., Komuna e L., ku edhe jeton, I gjenjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i R.Kosovës.

I akuzuari **E. O.**

### **ËSHTË FAJTOR**

**SEPSE**; me datën: 30.05.2009, rreth orës 04:14, në kafiterinë ‘‘U.’’, në rrugën P. – F., pas përdorimit të alkoolit, pasi i aka marrë paraprakisht revolën e shokut të tij F., duke dashur që ta frikësoj të dëmtuarën E., ka shkrepur Brenda në restorant dy herë, duke e goditur me një predhë të dëmtuarën E. në këmbë, e duke i shkaktuar lëndim trupor,-

-me çka ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së

Konform neni 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPPRK-së.

### **REFUZOHET AKUZA**

**SE**: me datën: 30.05.2009, rreth orës 04:14, në kafiterinë ‘‘U.’’, në rrugën P. – F., pas përdorimit të alkoolit, pasi i aka marrë paraprakisht revolën e shokut të tij F., duke dashur që ta frikësoj të dëmtuarën E., ka shkrepur Brenda në restorant dy herë, duke e goditur me një predhë të dëmtuarën E. në këmbë, e duke i shkaktuar lëndim trupor,-

-me çka kishte për të kryer veprën penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.1 lidhur me par.4 dhe 5 të KPK-së,

Ndaj të akuzuarëve: **E. V., G. A., A. T., F. T. dhe F. E.**

Konform neni 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPPRK-së.

### **REFUZOHET AKUZA**

**SE**: me datë 30.05.2009, derisa ishin duke punuar në restorantin ‘‘U.’’, në L., në rrugën P. – F., ku i pandehuri E. O., kishte shti me revolënë restorantin e tyre dy her, mirëpo të njëjtit edhe pse e kanë ditur se I pandehuri ka kryer veprën penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.1 lidhur me par.4 dhe 5 të KPK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së, rastin nuk e kanë lajmëruar në policinë e Kosovës,-

-me çka kishin për të kryer veprën penale: Moslajmërimi i veprës penale nga neni 304 par.2 të KPK-së,

Andaj gjykata në kuptim të neneve 2,3,7,17,41,43,46,62,73,83, të KPRK-së dhe nenit 363, 365, 453, 454 463 të KPPRK-së.

Të akuzuarit **E. O.**

Për veprën penale: mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPPK-së i shqipton **DENIM ME GJOBË** në shumën prej 1.200 € (njëmijë e dyqind euro), Në këtë shumë i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak, nga data 23.09.2010 deri me dt.22.10.2010 i llogaritet në denimin e shqiptuar,

**Shumën e mbetur prej 600 euro i gjykuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas lotfuqishmërisë së aktgjykimit.**

Në rast se denimi me gjobë nuk mundë të realizohet as me detyrim konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, Gjykata këtë denim me gjobë do ta zavendësoj me denim burgu, ashtu që **20 € (njëzet euro)** të denimit të shqiptuar llogaritet me një ditë burgim.

Sa I përket veprës penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.1 lidhur me par.4 dhe 5 të KPK-së, Konform nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPPRK-së.

### **REFUZOHET AKUZA**

Sepse prokurori i qështjes ka hjek dorë nga ndjekja penale, për veprën penale në fjalë.

Ndaj të akuzuarëve: **E. V., G. A., A. T., F. T. dhe F. E.** për veprën penale: Moslajmërimi i veprës penale nga neni 304 par.2 të KPK-së, konform nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPPRK-së.

### **REFUZOHET AKUZA**

Sepse prokurori i qështjes ka hjek dorë nga ndjekja penale, për veprën në fjalë

E dëmtuara **E. B.** për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

### **MBI DENIMIN PLOTËSUES**

Konform nenit 62 par.2 nën.par.2.7 të KPK-së ndaj të akuzuarit **E. O.** konfiskohet një predhë, dhe e njejta duhet të asgjësohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Për të akuzuarit **E. V., G. A., A. T., F. T. dhe F. E.** shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës

Ndërsa i akuzuari E. O. obligohet të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë **30 € (tridhet euro)**, në afat prej 15 (pesëmbëdhjet) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

#### **A r s y e t i m**

Ish Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të rënda, ka ngritur aktakuzë PP.nr.120-2/2010, të dt: 13.08.2012, kundër të akuzuarëve: E. O.për shkak të veprës penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.1 lidhur me par.4 dhe 5 të KPK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së, të akuzuarit E. V., Genc Aliu, A. T., F. T. dhe F. E. për shkak të veprës penale: Moslajmërimi i veprës penale nga neni 304 par.2 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësorë me dt:29.11.2017, me çrast nuk janë ftuar të akuzuarit E. V., G. A., A. T., F. T. dhe F. E., sepse vepra penale me të cilën të njejtit janë ngarkuar me aktakuzë është parashkuar.

Para leximit të aktakuzës, prokurori i çështjes ka hjekur dorë për veprën penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.1 lidhur me par.4 dhe 5 të KPK-së, me të cilën është ngarkuar I akuzuari E. O., e poashtu edhe veprën penale Moslajmërimi i veprës penale nga neni 304 par.2 të KPK-së, me të cilën kanë qenë të ngarkuar të akuzuarit: E. V., G. A., A. T., F. T. dhe F. E., sepse sipas prokurorit të çështjes nga koha e kryerjes së veprës penale e deri me tani ka kaluar më shumë se 8 vite, dhe për shkak të arritjes së parashkrimit absolut të ndjekjes penale ka heq dorë nga veprat penale në fjalë, ndërsa ka mbetur pranë aktakuzës ndaj të akuzuarit E. O. për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle, posedim ose shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së.

Pas leximit të aktakuzës, i akuzuari E. O., ka deklaruar se e ndien vetën fajtorë për veprën penale nga neni 328 par.1 të KPK-së, pranim të cilin e ka bërë pas konsultave të mjaftueshme me mbrojtësen e tij të angazhuar sipas autorizimit.

Pas deklarimit të të njejtit lidhur me pranimin e fajësisë për veprën penale e cila i vëhet në barrë, me të cilin pranim është pajtuar mbrojtësi dhe prokurori i shtetit, gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kushtet nga neni 248 par.1 i KPPRK –së, pikërisht se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë. Pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza, në materialin e prezantuar nga prokurori i shtetit, të pranuar nga i akuzuari. Prandaj gjykata e aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, sepse janë përmbushur kushtet për pranimin e fajësisë nga neni 248 par.1 të KPPRK –së.

Gjykata paraprakisht të akuzuarin e ka udhëzuar se me pranimin e fajësisë i njejtit do të shpallët fajtorë për veprën e cekur më lartë dhe do t'i shqiptohet sanksioni i paraparë me ligj, mirëpo gjykata gjatë marrjës së vendimit mbi denimin, do ta ketë parasysh pranimin e fajësisë si rrethanë letësuese.

Duke e marr parasysh se në shqyrtimin gjyqësorë ka ardhur deri te pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, gjykata pa prezentimin e provave ka kaluar në fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit A. H. në fjalën përfundimtare ka deklaruar: dyshimi mirë i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, vërtetohet si nga provat e paraqitura në aktakuzë poashtu edhe nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit. Andaj gjykata të njejtë ta shpall fajtorë dhe ta denoj në përputhje me ligjin, kurse si rrethanë lehtësuese ta ket parasysh se i njejtë e ka pranuar fajësinë.

Mbrojtësja e të akuzuarit E. O., av.F. G. B. në fjalën përfundimtare ka deklaruar: e përkrahi deklarimin e klientit tim, dhe këtë e ka bërë që nga kontakti me policinë, duke besu se trupi gjykues do ta vlerësoj dhe nga praktika gjyqësore do ti shqiptoj një denim meritor që do të ishte adekuat për tu arritur qëllimi I denimit

I akuzuari E. O. në fjalën përfundimtare deklaroi se: në tërësi e përkrahë fjalën përfundimtare të mbrojtësit, jam përdorur për veprimet e mia, dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmën asnjëherë nuk do të bie ndesh me ligjin.

Me rastin e përcaktimit të denimit Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e denimit, kështu që ndaj të akuzuarit morri parasysh pranimin e fajësisë dhe pendimin e thellë të shprehur gjatë shqyrtimi, si rrethanë veqanarisht lehtësuese, sjelljen korrekte të njejtë, që është njeri familjarë i martuar, baba idy fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, më parë jo i gjykuar dhe ndaj tij nuk zhvillohen procedura për ndonjë veprë tjetër penale. Nga rrethanat rënduese gjykata asgjë nuk gjeti. Andaj gjykata të akuzuarin e shpalli fajtorë dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se denimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës dhe përgjegjësisë penale dhe i njejtë do të shërbejë si preventivë individuale dhe gjenerale dhe parandalim se në të ardhmën nuk do të kryen vepra penale, duke ndikuar në rehabilitimin e tij.

Gjykata është e bindur se me denimin e shqiptuar në tërësi do të arrihet qëllimi i denimit siç është rregulluar me nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi denimin plotësues gjykata e ka bazuar ne nenin 62 par.2 nënpar.2.7 të KPRK-së.

Në bazë të nenit 454 par.1 të KPRK-së për të akuzuarit E. V., G. A., A. T., F. T. dhe F. E., është vendosë që shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale për të akuzuarin E. O. gjykata e morri në bazë të nenit 450 par.2 nën.par.2.6 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 463 par.2 të KPRK-së

Nga se u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij atkgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**P.nr.839/12, të dt. 29.11.2017**

**Procesmbajtësi,**  
**Arianit Mahmutaj**

**Kryetarja e trupit - gjyqtarja,**  
**Shadije Gërguri**

**KESHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate